

| Nr. | Drejtoria/Struktura | Detyrat funksionale të drejtorisë | Drejtori |
|-----|---|--|--|
| 1 | Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil | <ul style="list-style-type: none"> • Harton politikat e rekrutimit të nëpunësve civilë në institucionet e administratës publike, në bashkëpunim me njësitë e tjera organizative në përbërje të DAP-it. • Administron planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore. • Organizon procedurat e pranimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë në institucionet e administratës shtetërore, konform planit vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe legjislacionit të shërbimit civil në fuqi. • Mbështet Komitetet e Përhershme të Pranimit, Komitetet e Pranimit për Lëvizjen Paralele, si edhe të Komitetet e Pranimit për Ngritjen në Detyrë. • Luan rolin e Sekretariatit Teknik për Komitetin Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues. • Administron kërkesat për transferim të përkohshëm e të përhershëm dhe merr vendim për këto procedura konform legjislacionit në fuqi të shërbimit civil. • Administron të dhënat në lidhje me emërimet, lirimet, pezullimet, transferimet, masat disiplinore dhe çdo lëvizje tjetër në institucionet e administratës shtetërore duke mbajtur rekordet përkatëse. • Mbikqyr procesin e transferimit të nëpunësve civilë pas ristrukturimit apo mbylljes së institucioneve të administratës shtetërore. | <p style="text-align: center;">Znj. Agathi Kuramano</p> <p>Znj. Agathi Kuramano është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej muajit Maj 2016 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil që nga muaji Tetor 2018. Është diplomuar si juriste pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, duke ndjekur më pas studimet Post Master në Universitetin “Aldo Moro”, në Itali</p> |
| 2 | Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Institucioneve dhe Pagave | <ul style="list-style-type: none"> • Harton politikat e qeverisë shqiptare në fushën e pagave për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. | <p style="text-align: center;">Znj. Enkela Dudushi</p> <p>Znj. Enkela Dudushi është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej Nëntorit të vitit 2001 dhe mban pozicionin e</p> |

| | | | |
|---|---|--|---|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Harton politikat e qeverisë shqiptare në fushën e zhvillimit organizativ e funksional të institucioneve të administratës shtetërore. • Përgatit aktete ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave për të gjithë nëpunësit/punonjësit e administratës publike. • Përgatit aktet ligjore dhe nënligjore të lidhura me përcaktimin e standarteve për ndërtimin strukturor dhe organizativ të institucioneve të administratës shtetërore. • Përgatit projekturdrat e Kryeministrit për miratimin e strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës publike. • Jep mendim për strukturat dhe organikat e institucioneve të pavarura, si dhe për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore që miratohen nga Këshilli i Ministrave apo bordet/këshillat drejtuese të agjencive autonome. | Drejtorit të Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Institucioneve dhe Pagave që prej vitit 2008. Ajo është diplomuar në degën administrim biznes pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1993. Znj. Dudushi ka një karrierë rreth 20 vjeçare në administratën publike |
| 3 | Drejtoria e Programeve të Reformës në Administratën Publike | <p>Kjo drejtori është përgjegjëse për përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të programeve dhe projekteve në fushën e reformës së administratës publike, e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programet e modernizimit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore – ndërveprimi, unifikimi i proceseve, etj. • Projektet – identifikimi dhe inicimi i projekteve në përputhje me programin dhe strategjitë e zhvillimit, hartimi i projekteve të plota (që përfshijnë projektet teknike), vlerësimi i fizibilitetit të tyre, vlerësimi i impakteve etj. • Siguron administrimin dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit, si dhe ushtron çdo kompetencë të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar dhe VKM nr. 117/2014, në lidhje me këtë sistem. | <p>Z. Ened Kercini</p> <p>Z. Ened Kërçini është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej vitit 2014 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike. Ai është diplomuar për Inxhinieri Elektronike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës në vitin 1993. Z. Kërçini vjen nga një eksperiencë rreth 15 vjeçare në sektorin privat</p> |
| 4 | Drejtoria e Politikave të Rritjes profesionale, | Kjo drejtori, bazuar në legjislacionin mbi integritetin e nëpunësve publikë, si dhe në legjislacionin e nëpunësit civil, ka në përgjegjësi të saj: | Z. Fatmir Demneri |

| | | | |
|--|-------------------------------------|---|--|
| | <p>Integritetit dhe Inspektimit</p> | <ul style="list-style-type: none">• Ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve në bazë të legjislacionit për integritetin e nëpunësve publikë.• Mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil në institucionet e administratës shtetërore pjesë të fushës së veprimit të këtij legjislacioni.• Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e rritjes profesionale të administratës publike. | <p>Z. Fatmir Demneri është pjesë e Departamentit të Administratës Publike që prej vitit 2018 dhe mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Politikave të Rritjes Profesionale, Integritetit dhe Inspektimit. Ai është diplomuar për Inxhinieri Tekstili pranë Universitetit Politeknik të Tiranës në vitin 1995. Z. Demneri ka një karrierë rreth 22 vjeçare në administratën publike</p> |
|--|-------------------------------------|---|--|